

Paskajorja Gege nuk mund të Pranohet në Standardin '72 arbanika.com

Paskajorja mbetet çashtja kryesore që dallon gegnishten letrare prej tosknishtes letrare. Fatqesisht kjo paskajore nuk mund të integrohet me standardin e sotëm sepse shumica e paskajoreve u përkasin atyne aspekteve ku gegnishtja e tosknishtja përjashtojnë njëra-tjetrën. Megjithatë, standardi nuk ka arsye të mbetet pa paskajore.

Në gjuhë, standardi është si ligji në jetën publike; edhe pse nuk pajtohesh me të, duhet ta zbatosh; përndryshe do të kesh pasoja të padëshirueshme. Por, standardizimi i gjuhës shqipe ka një problem të veçantë: 50 vjet përpjekjesh tregojnë që shumica e gegfolësëve nuk po e zotnojnë atë.

Standardi

Standardizuesit e cilësdo gjuhë detyrohen me marrë parasysh, trajtat më të lashta, trajtat më të reja, trajtat më popullore, trajtat e një dialekti të veçantë, ose diçka tjetër. Cilado qoftë zgjedhja, ajo duhet justifikua me arsyetim shkencor (aq sa gjuha mund të jetë shkencë). Megjithëse gjuha ka ndryshuom tash 50 vjet, Standardi '72 u pat ngritur mbë baza shkencore. Çashtja e tij nuk është moskompenca, por mospërkimi i tij me gegnishten letrare.

Kyçi i dallimit në mes të gegnishtes letrare e tosknishtes letrare gjindet në togzanorin ua/ue dhe në rotacizimin e tingujve n/m. Veçsisht togzanori ua/ue është i randsishëm sepse ai del në formën bazë të shum pjesëve të ligjrates dhe në derivatet që janë formuom prej këtyne pjesëve.

a. Ne Folje

1. Në pjesore
 - blua(r), shkrua(r), punua(r), luajt(ur), gjuajt(ur)
2. Në paskajore
 - -

3. Në përcjellore
 - duke shqua(r), duke u shqua(r)
4. Në mohore
 - pa shqua(r), pa u shqua(r)
5. Në trajtat e foljeve sinthetike
 - shquaj, shquan, shquajm, shquani, shquajn
 - shquaja, shquaje, shquante, shquanim, shquanit, shquanin
 - u shqua, u shquam, u shquat, u shquan
 - e shquan, t'a shquan
 - shquakam, shquake
 - shquaj!, shquani!
6. Në trajtat e foljeve analitike
 - kam shqua(r), jam shqua(r)
 - kisha shqua(r), isha shqua(r)
 - pata shqua(r), qeshë shqua(r)
7. Në trajtat e kushtores, të së ardhemes në të kaluomen, dhe lidhores
 - do të kisha shqua(r)
 - kisha për të shqua(r)
 - të kisha shqua(r), të kishe shqua(r)
8. Në fraza parafjalore
 - Ai erdhi për të kremtuar Buzëmin.
 - Dëshira e vajzës për të lexuar ishte e pafund.
9. Në absoluteve
 - me të shquar...
 - një të shquar...
 - të shquarën...

b. Në Emëna

- muaj, kuaj, duaj, huall, truall, kapruall (kaproll-i), shuall (shollë-a), shpuar (shpor-i), zguar (zgor-i)
- dragua, fajkua, fashua, ftua, grua, hua (Dukagjin: hue), katua, langua, pallua, përrua, potkua, thua, vargua, zgjua

c. Në Përemëna

- mua, tuaj, juaj, suaj

ç. Në Mbiemëna

- i huaj, e huaj, të huaj

d. Në Mbiemëna Prejppjesorë

- i, e gëzuar; i, e luajtur

d. Në Fraza Ndajfoljore

- në mënyrë të gëzuar

Siç tregojnë shembujt e masipërm, pranimi i paskajores që sosë më -ue do t’a kthente standardin prej në tosknisht në gegnisht.

Norma Letrare

Vilhelm von Humboldti shkruan që detyra e folësve të një breznie është me e rilindë gjuhën. Ashtu si natyra rilindet në çdo pranverë, por çdo herë në mënyrë të veçantë, ashtu edhe gjuha duhet të rilindet në çdo brezni. Kjo do të ishte kulturë gjuhsore.

Standardi është si shenjat e qarkullimit. Ai të udhëzon si mos me thye rregullat, por ashtu si mësimi përmendësh i rregullave të qarkullimit nuk të ban shofer, as mësimi i rregullave të standardit nuk të ban shkrimtar.